



**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SH.A.
DEPARTAMENTIT TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Tiranë, më 25. 06.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PARAPRAK)**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “KREATX” sh.p.k, me adresë, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr. 2, Tirane.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur sherbime” – me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04938-05-15-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Upgrade i teknologjise Hardware/Software si dhe perditetim te funksionaliteve ne sistemin e matjes Mobiread”.

Publikimet e mëparshme: Nuk ka

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 26 datë 20.05.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kane marrë pjesë Ofertuesit si mëposhtë me vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “KREATX” shpk, me nr. NIPT L12121023B me vlere oferte 33,800,000 (Tridhjetë e tre milion e teteqind mije) leke pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “INSTAN.AL” shpk me Numer NIPT L81506043D, me vlere oferte 31,800,000 (Tridhjetë e nje milion e teteqind mije) leke pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit eshte skualifikuar Ofertuesi “INSTANT.AL” shpk pasi:

1. Operatori Ekonomi “INSTANT.AL” shpk, nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertes.



2. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” shpk, nuk ka paraqitur Vertetimin e Xhiros ne vleren e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.
3. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” shpk, nuk ka paraqitur kopje te Bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet perkatese.
4. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” shpk, nuk ka paraqitur deshmi per shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në nje vlere jo më të vogel se 15,000,000 (Pesëmbdhjete milion) leke pa TVSH.
5. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” shpk, nuk ka paraqitur çertifikimet si kompani sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe ISO 27001:2013 ose ekuivalente për Sigurinë e Informacionit (të vlefshme).
6. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” shpk, nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi / distributori ose certifikatën e të drejtave të autorit për produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurorimi për territorin e Shqipërisë.
7. Autoriteti Kontraktor ne shtojcen 8 “Formulari i Kritereve te Perzgjedhjes”, pika 2 “Kriteret e Veçanta te Kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, 2.3.4 ka kerkuar qe Ofertuesi duhet te ketë të punësuar ose me kontrate bashkepunimi jo më pak se 9 (nëntë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj).
8. Operatori Ekonomik “INSTANT.AL” shpk nuk ploteson kete pike, pasi ne formularin permbledhes te vetedeklarimit ka deklaruar vetem 6 punonjes.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “KREATX” sh.p.k, me adresë, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr. 2, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 33,800,000 (Tridhjete e tre milion e teteqind mijë) leke pa TVSH / totali i pikëve të marra 100 është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.